



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK**

**Procesverbal i Konsultim publik mbi Planin e Arsimit parauniversitar i
Bashkise Puke**

Data : 29/08/2025 Ora : 12:00

Vendi: Puke

Numri i pjesëmarrësve : 21 , 10 burra dhe 11 gra

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

Plani i Arsimit parauniversitar i Bashkise Puke 2025-2028

**Takimi drejtohet nga Z. Ferit Ringaj Zv.Kryetari i Bashkise i cili bëri një
prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- ✦ Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik

- ✦ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- ✦ Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Hapi degjesen nenkryetari i Bashkise z. Fent Ringaj. Degjesa u mbajt për te pergatitur planin vendor per asimin parauniversitar , per te diskutuar mbi strategjite dhe prioritet për vitet 2025-2028 dhe per te paraqitur për mendimet dhe pervahtat e te gjithve.

Mori fjalën znj. Florinda Dedaj per te paraqitur planin dhe nje permbledhje te tij. Vendosi theksin ne barazine per shkolim te te gjith femijve dhe per nje edukim gjithperfshires , qe integron secilin femije.

U diskutua per nevojën per nje nje arsimim cilesor me infrastrukture dhe mjete didaktike te nevojshme. Pike kyse aksesit i gjith femijeve ne arsim dhe e permiresimi i infrastruktures.

Z. Ferit Ringaj shtoi se bashku me planin eshte dhe matrica e aktivitetëve qe permireson cilesine e infrastruktures dhe mjeteve didaktike .

Plani i Arsimit parauniversitar u prezantua nga : zj. Florinda Dedaj, specialiste e drejtorise se Turizmit , Arsimit dhe sportit.

^ Plani i Arsimit Parauniversitar 2025–2028 për Bashkinë Pukë është një dokument strategjik i domosdoshëm që synon të orientojë zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve arsimore në territorin e bashkisë për tre vitet e ardhshme. Hartimi i tij është rezultat i një analize të thelluar të situatës aktuale, tendencave demografike, nevojave komunitare dhe sfidave ekzistuese në arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm. Ky dokument është një instrument thelbësor planifikimi për strukturat vendimmarrëse dhe administrative për të garantuar një arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Bashkinë Pukë.

Kuadri Ligjor dhe Institucional

Plani mbështetet në një kuadër të gjerë ligjor kombëtar, përfshirë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe ligjet dhe udhëzimet përkatëse për menaxhimin financiar, mbrojtjen e fëmijëve dhe gjithëpërfshirjen në arsim. Në bazë të këtyre akteve, Bashkia Pukë ka detyrimin dhe përgjegjësinë për të hartuar politika zhvillimore në fushën e arsimit dhe për të siguruar infrastrukturë, staf të kualifikuar dhe shërbime të barabarta për të gjithë. Gjithashtu, për referencë janë marrë në konsideratë dhe në shqyrtim edhe baza ligjore si më poshtë:

Ligji Nr. 9936/ 2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; **Ligji Nr. 68/ 2017** “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; **Ligji Nr. 9632/ 2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për Funkcionimin e

Institucioneve Arsimore Parauniversitare”

Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”

Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”

Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”

Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024, “Për miratimin e Kornizës së Vlerësimit të Cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

Ligji Nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

Ligji Nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025

Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”

Udhëzim i përbashkët MAS–MSHMS nr. 658, datë 23.09.2019, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-social dhe përfshirja sociale

Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko- social në institucionet e arsimit parauniversitar”

Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore

Vizioni dhe Objektivat Strategjike

Vizioni i planit është të garantojmë një sistem arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për çdo fëmijë dhe të ri në territorin e Bashkisë Pukë, objektivat strategjike përfshijnë:

Rritja e aksesit në arsimin parauniversitar për të gjithë fëmijët e Bashkisë Pukë, me fokus në zonat më të pafavorizuara dhe grupet vulnerabël.

Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përdorimi i metodave bashkëkohore në procesin e mësimdhënies

Forcimi i kapaciteteve të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave për të siguruar një menaxhim efikas dhe inovativ.

Mbështetjen për fëmijët me aftësi ndryshe dhe nga grupe të marginalizuara,

Forcimin e rolit të shkollës si qendër komunitare.

Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar në Bashkinë Pukë është ndërtuar në përputhje të plotë me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026, duke siguruar që objektivat dhe masat e ndërmarra në nivel lokal të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të integruar të arsimit në nivel kombëtar. Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Pukë dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parauniversitar.

Kjo përputhje i jep Planit Vendor një qasje të integruar dhe garanton që çdo ndërhyrje në territorin e Bashkisë Pukë është pjesë e një vizioni më të gjerë kombëtar për një sistem arsimor më të fortë, më gjithëpërfshirës dhe më cilësor.

Buxheti dhe Burimet Financiare

Financimi i planit do të sigurohet përmes të ardhurave vendore, transfertave nga buxheti i shtetit dhe projekteve të bashkëpunimit. Janë përcaktuar nevojat buxhetore vjetore për secilën masë ndërhyrjeje, si dhe është hartuar një planifikim afatmesëm buxhetor për të mbështetur realizimin e objektivave. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje në arsimin parashkollor të fëmijëve nga grupe vulnerabël.

Arsimi 9-vjeçar Arsimit i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;

Në këtë plan është përfshirë listëa e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2025 -2028 (në mijë lekë) e cila përfshin projektet që do të financohen nga Buxheti i Bashkisë Pukë gjatë kësaj periudhe., bashkëlidhur.

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë zbatimi e monitorimi, vlerësimi të progresit si dhe raportim e transparence të pershkruara si me poshte:

Mekanizmat e Zbatimit dhe Monitorimit

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Pjesëmarrësit që morën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Hapet diskutimi pjesëmarrësit paraqiten problematikat e tyre.

Mori fjalën z. Mustaf Mehaj kryetit fshatit Puke vuri theksin te rendesia qe ka sporti në jetën e të rinjve dhe femijeve që rriten ne qytetin tone duke kerkuar leje qe te shfrytezohen ambjentet sportive te qytetit per moshat e reja per zhvillimin e sportit . Nga z. Ferit Ringaj u dha premtim per zgjidhje shume te shpejta nga Bashkia. Mori fjalën Artan Gjoni drejtor i shkollës Gjegjan duke paraqitur problematikat per bazen materiale edhe didaktike te shkolles, duke kerkuar nderhyrje nga Bashkia.

Mori fjalën z. Sokol Gjoni DB NJ Bashkia Puke, duke theksuar se pikat kryesore te Planit perfshine infrastrukturen mjetet didaktike. Ne vijim z.Ndue Dervishi drejtor i shkolles Migjen "Puke" dhe shtroi problematiken e mungeses se mjeteve didaktike dhe materiale te higjenes sanitare ne shkolle.

Mori fjalën z. Vladimir Kola drejtor i shkolles se Mesme Puke, ku diskutoi per prespektiven e arsimit ne Puke ne te ardhmen, duke parë tendencën e uljes se numrit te nxenesve, zhvillimi ne nje hark kehor prej tre vitesh, shtroi problemin e krijimit ten je kompleksi shkollor te perbashket per shkollat dhe konviktin.

Z. Feit Ringaj dakortesoi faktin qe duhen bashkuar te gjitha ambjentet e pershtatshme te parbanketa, z. . Ferit Ringaj ra dakort me faktin se tkurrja e popullsise eshte nje problem kryesor dhe duhet te pershtatet ne planin strategjik per mbarevajtjen e arsimit ne Bashkine Puke, shtoi faktin se do te vihet ne dispozicion buxheti per mjete didaktike dhe infrestrukturore.


Mori fjalën Zj. Blerina Pemaj duke falenderuar për fillimin e punimeve për investimet në shkollën 9-vjeçare Migjeni. Specifikoi faktin se ulja e numrit të nxënësve është problem i madh për gjithë komunitetin dhe sistemin arsimor. Paraqiti kërkesën për lysterjen e shkollave që në qershor pas mbylljes së vitit shkollor, gjithashtu dhe paisja me dru zjarri që në muajin Qershor.

Zj. Mirjana Selmani duke folenderuar Bashkinë për mbështetjen dhe parashtrroi kërkesën për një rikonstrukcion godines së kopshtit "Erjola Lluka" në qytetin e Pukës.

Gjithashtu theksoi nevojën për mesues ndihmes për fëmijet me aftësi ndryshe. Zj. Blerina Pema vuri theksin në mangësitë në shkollë si paketa e sigurisë dhe nevojën për nderhyrje në shkollën e Gomsiqes. Duke falenderuar të pranishmit u mbyll diskutimi.


Mbajtësi i procesverbalit

Iris Latifi



Sekretari i Këshillit

Hazbi Terhuni



Lista e pjesemarrësve ne konsultimin me publikun : date 29.08 .2025

"Per prezantimin e planit per Arsimin Parauniversitar te Bashkise Puke 2025-2028"

Nr	Emri Mbiemri	Institucioni	Nr. kontaktit	Firma	Verejtje
1	Sandra Suta	Dashkia	0683486362		
2	Arbën Tashiri	Dashkia	0682659438		
3	Ullashmir Topolci	Sabah Sinori	068231100		
4	Ali Hadri	Dashkia	068394420		
5	Adrie Jeyush	Dashkia	0682340103		
6	Mirjana Selman	Kop. E. LUKA	0674976412		
7	Angje Ulizaj	Kop. E. LUKA	0682563179		
8	Emine Liuka	Adm. Luf-Qemet	0688859082		
9	Nardie Teubeci	Bashkia	0683986323		
10	Enigert Mlati	H. H. Rrapo	0685658917		
11	IRIS LATIFI	B. Puke	0692867471		
12	Florinda Dedaj	B. Puke	0699405052		
13	Sokoc Mami	B. Puke	0682022742		
14	Ferit Rimgaj	B. Puke	0686341973		
15	Ferit Rimgaj	B. Puke	0692797008		
16	VINJOLA KALISI	DR. KONVIKT	0696310708		
17	HIDISE HISENI	Edukatore	0686187744		
18	VJOLLCA DQÇI	Qytetore Puke	0688371469		
19	Berinda Jomaj	ZVAPUKO	0692422741		
20	Anila Cenaj	Panoise socole	0692257347		
21	Besna Kuci	Antor Keshit	0689371464		
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					
31					
32					
33					
34					
35					
36					
37					
38					
39					
40					

Secretari i bashkisë